




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SUHAREKËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës (Komuna e Suharekës), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Suharekës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Suharekës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- A1 Pasaktësi në regjistrimin e pasurisë kapitale.
- A2 Dhënia e subvencioneve jo në përputhje me thirrjen publike.
- B1 Zotimi i mjeteve jo sipas rregullave financiare.
- B2 Mungesa e projektit ekzekutiv.
- B3 Vonesa në realizimin e projekteve.
- B4 Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimit në pronë.
- C1 Vonesa në ekzekutimin e pagesave të faturave.
- C2 Mangësi në raportimin e rregullt për shfrytëzimin të pronave komunale.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Suharekës.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Suharekës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Suharekës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Suharekës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Suharekës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Procesi i raportimit në Komunë ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF). Pas kërkesës sonë disa çështje të ngritura në PVF-të janë korrigjuar dhe dorëzuar në MF. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në menaxhimin e pasurive, të hyrave, llogarive të arkëtueshme, klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e projekteve kapitale, si dhe në procedurat e prokurimit publik të cilat janë paraqitur me poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me dhjetë (10) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja, pesë (5) rekomandime të përsëritura, si dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura.

Si rezultat i kontratës kolektive me procedurë përbarimore/gjyqësore komuna ka paguar borxhin kryesor në shumë 409,284€ për paga dhe mëditje, ndërsa shpenzimet shtesë (interesit) procedurale të përbarimit/gjykatës ishin 63,961€.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Pasaktësi në regjistrimin e pasurisë kapitale

**Gjetja** Rregullorja Nr. 02/2013- "Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore", neni 6 përcakton se; pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Në bazë të rishikimit, kemi vërejtur në dy raste se regjistrimi i pasurisë kapitale nuk është bërë si duhet:

- Komuna kishte regjistruar pagesën prej 17,015€ nga transferi kapital për entitete publike për projektin "Marrëveshje bashkëfinancimi për ndërtimin e objektit të lagjes Zekolli në Bllacë" si pasuri të saj dhe e kishte vënë në përdorim, gjersa në marrëveshje nuk ishte definuar pronësia. Vlera totale e projektit është 37,891€;
- Po ashtu, pagesën e bërë prej 18,844€, për projektin "Marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi për kufizimin e varrezave në fshatin Shirokë", e kishte regjistruar si pasuri në përdorim edhe pse ishte bashkëfinancim me bashkësinë islame dhe ky projekt nuk kishte përfunduar ende, rrjedhimisht nuk dihet sa është pjesa e investuar nga bashkësia islame dhe a është bartur kjo pjesë tek komuna.

Shkak i regjistrimit me gabime të pasurisë ishte mungesa e kontrolleve të brendshme adekuate dhe mos përgjegjësi e zyrtarit përgjegjës.

**Ndikimi** Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmenti lidhur me pasurinë që posedon komuna, rrjedhimisht shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive që mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A2 - Dhënia e subvencioneve jo në përputhje me thirrjen publike

**Gjetja** Bazuar në thirrjen për aplikim nr. 08-41 të datës 21.02.2023 nga Drejtoria e Bujqësisë për subvencionimin e ndërtimit të serave në Komunën e Suharekës, ndër kriteret e kërkuara për aplikim ishte edhe kërkesa që aplikantët duhej të kishin minimum të fondit të tokës prej 0.50 ha në pronësi të tyre.

Në dy (2) raste, kemi vërejtur se përfituesit e subvencionit nuk kishin plotësuar kriteret sipas thirrjes publike, ngase të njëjtit nuk plotësonin fondin e kërkuar të tokës në dispozicion (0.50ha).

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mospërgjegjshmërisë së komisionit të

vlerësmi i cili kishte vendosur për aprovimin e kërkesës jo në përputhje me kriterët e thirrjes.

**Ndikimi** Subvencionimi jo në përputhje me thirrjen publike, ndikon negativisht tek aplikuesit tjerë mbi transparencën e procesit të ndarjes së subvencioneve.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të përmirësojë procesin e vlerësimit për dhënien e subvencioneve, duke siguruar që vetëm aplikantët që plotësojnë kriteret të përfitojnë nga subvencionimi.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B1 - Zotimi i mjeteve jo sipas rregullave financiare**

**Gjetja** Rregulla financiare Nr.01/2013 neni 12 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër- blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Në 13 raste me vlerë totale 127,090€, fillimisht ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja.

Shkaku i një dukurie të tillë është planifikimi jo adekuat i buxhetit dhe inicimi i procedurave duke shpërfillur zbatimin e rregullave në fuqi.

**Ndikimi** Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme dhe duke mos ndjekur procesin e shpenzimeve, krijojnë vështirësi të menaxhimit financiar apo të vie edhe tek mos kryerja e obligimeve nga të cilat mund të kenë kosto shtesë.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B2 - Mungesa e projektit ekzekutiv**

**Gjetja** Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (UOPP), neni 20 pika 10, kërkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutiv si pjesë substanciale të vetën".

Gjatë testimit, kemi vërejtur se për tri (3) projekte kapitale nuk ishte përgatitur projekti ekzekutiv, por komuna kishte iniciuar procedurat e prokurimit vetëm me paramasë dhe paralogarinë. Rastet e tilla ishin si në vijim:

- Projekti "Ndërtimi i vend kampingjeve turistike në Mushtisht dhe shtigjet e ecjes" në vlerë 52,650€;
- Projekti "Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave në qytet" në vlerë 179,452€; dhe
- Projekti "Ndërtimi i nfrastukturës për turizëm në bjeshkën e Vraniqit" në vlerë 28,510€.

Shkaqet e mos hartimit të projektit ekzekutiv ishin vonesat gjatë ndjekjes së procedurave të prokurimit, si dhe mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procesit të prokurimit.

- Ndikimi** Zhvillimi i procedurave të prokurimit pa projekt ekzekutiv, mund të ndikoj që punimet e ekzekutuara në këto projekt të devijojnë nga kërkesat standarde të ndërtimit dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur.
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë hartimin e projekteve ekzekutive infrastrukturore para inicimit të procedurave të prokurimit.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B3 - Vonesa në realizimin e projekteve

- Gjetja** Sipas nenit 81 të Ligjit për Prokurim Publik si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik pika 61.6, 61.19 dhe 61.20, menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Në (6) gjashtë raste, komuna nuk kishte realizuar punimet sipas planit dinamik, si vijim:

- Projekti ‘Ndërtimi i rrugëve locale në Sopiye-Vraniq dhe Reqan-Bukosh’ kontrata e nënshkruar me 22.05.2023, në vlerë prej 318,064€ ishte valide për 79 ditë kalendarike. Pagesa e situacionit të parë ishte realizuar në muajin tetor dhe përbënte vetëm 30% të punimeve të kryera. Për këtë projekt vonesat janë mbi 120 ditë.
- Projekti ‘Ndërtimi i rrugëve lokale në Mushtisht’, kontrata është nënshkruar me 04.05.2023 në vlerë prej 109,615€ me afat të përfundimit prej 41 ditë kalendarike. Pagesa e kryer në vlerë prej 40,000€ është vetëm situacioni i parë ku është tejkaluar afati i kontratës se nënshkruar mbi 90 ditë.
- Projekti ‘Rregullimi i Kolektorit’, kontrata është nënshkruar me 21.07.2023 me afat prej 53 ditë kalendarike gjerësa pagesa e kryer 35,284€ më 27.12.2023, që përbën vetëm 24% të vlerës së kontratës së nënshkruar, për këtë projekt vonesat janë mbi 60 ditë.
- Projekti ‘Ndërtimi i rrugëve lokale në Tërrnje’ kontrata ishte nënshkruar me 02.06.2023 dhe ishte planifikuar të përfundon brenda 35 dite, ndërsa pagesa përfundimtare është kryer në dhjetor 2023. Për këtë projekt, vonesat ishin 120 ditë.
- Projekti ‘Ndërtimi i rrugëve lokale në Javor’, kontrata është nënshkruar me 08.07.2022, në vlerë prej 34,885€, dhe ishte planifikuar të përfundon brenda 90 ditëve, ndërsa pagesa e situacionit të fundit në vlerë prej 11,458€ është kryer në muajin dhjetor, pra 90 ditë vonesë.
- Projekti ‘Ndërtimi i rrugëve lokale në Gjinovc dhe Topliqan’, kontrata është nënshkruar me 21.12.2022 në vlerë 68,432€, dhe ishte planifikuar të përfundon brenda 30 ditëve. Pagesa e fundit në shumë 12,503€ është kryer me 21.12.2023 dhe nuk janë dhënë sqarime për mos realizimin e këtij projekti në kohëzgjatje prej 1 viti.

Vonesat në realizimin e projekteve si rezultat i mungesës së mjeteve

buxhetore edhe dinamikës së ulët gjatë kryerjes së punimeve ishin si shkak i mos realizimit të projekteve sipas afateve të përcaktuara në kontrata.

**Ndikimi**

Mos realizimi i projekteve sipas kushteve të kontratës ka ndikuar që komuna të mos arrijë objektivat e përcaktuara, si dhe mund të shkaktojë vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

**Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të sigurojë mekanizma adekuat në forcimin e kontrolleve në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B4 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimit në pronë**

**Gjetja**

Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 përcakton se, personi fizik i cili vendos se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor (për të cilën e deklaron në Komunë), i lejohe zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.

Pas analizës së bërë, në lidhje me zbatimin e zbritjes së lejuar për vendbanimin parësor dhe zbatimit të Vendimit për regjistrimin e numrit personal, janë identifikuar mangësitë si në vijim:

Për 141 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në kërkesën për “Zbritje për vendbanim parësor”, mirëpo kjo zbritje është bërë për njësit e objekteve për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal, ku për pasojë rezulton më pak të hyra nga tatimi në pronë.

Ndërsa për 147 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, “Zbritjet për vendbanim parësor”, ne kemi vërejtur se kjo zbritje është aplikuar për objektet që kanë destinim për zyre dhe afarizëm.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos rishikimit/azhurnimit të data bazës dhe mos inspektimit për njësitë e objekteve të tatueshme nga ana e komunës.

**Ndikimi**

Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal dhe pa u deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, rezulton me përlllogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra për komunën.

**Rekomandimi B4**

Kryetari të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Departamentit të Tatimit në Pronë Komunale dhe Ministrisë së Financave në azhurnimin bazës se të dhënave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja C1 - Vonesa në ekzekutimin e pagesave të faturave****Gjetja**

Ligji nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 39.1 përcakton që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhërit nga gjykata/përmbaruesi.

Nga mostrat e testuara për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, kemi identifikuar pesë (5) raste në vlerë totale prej 24,220€, ku pagesat e faturave të pranuar nuk ishin ekzekutuara sipas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh. Vonesat për këto fatura ishin prej 42 ditë deri në 102 ditë. Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur se ka pasur kërkesa për inkasimin e mjeteve nga OE përmes procedurave përmbarimore/gjyqësore.

Për shkak të vonesave në pagesën e faturave, operatorët ekonomik kanë përdorur procedurën përmbarimore/gjyqësore për inkasimin e mjeteve. Nga analiza e raportit të shpenzimeve kemi vërejtur se Komuna ka paguar borxh kryesor 52,093€ si dhe shpenzime të interesit 2,960€ si rezultat i mosprocedimit të pageva brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është planifikim jo i mirë i buxhetit dhe mos pagesa me kohë e faturave nga drejtoritë përkatëse.

**Ndikimi**

Hyrja në obligime pa siguruara fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara apo implikimeve buxhetore për vitin aktual, si dhe kosto financiare si rezultat i ngarkesave shtese në emër të kamatave dhe shërbimeve të përmbarimit.

**Rekomandimi C1**

Kryetari duhet të siguroj se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhet brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbarimore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja C2 - Mangësi në raportimin e rregullt për shfrytëzim të pronave komunale****Gjetja**

Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 22 paragrafi 2 përcakton se; Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore ti paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.

Komuna kishte përgatitur raporte të rregullta gjashtë (6) mujore, mirëpo këto raporte nuk përmbanin informata lidhur me monitorimin dhe raportimin e realizimit të kontratave që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim të pronave komunale. Edhe në vitin aktual 2023 komuna kishte lidhur katër (4) kontrata të reja për shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, por nuk kishte raportuar për qëllimin e dhënies në shfrytëzim dhe mbikqyrjes së

tyre.

Shkak i ndodhjes është anashkalimi i kërkesave ligjore në lidhje me raportimin dhe mbikqyrjen e kontratave për shfrytëzim të pronës së paluajtëshme komunale.

**Ndikimi**

Mungesa e raportimit për monitorimin e kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim përveç se krijon pa pajtueshmëri ligjore dhe ndikon në realizimin e plotë të të hyrave.

**Rekomandimi C2**

Kryetari të sigurojë që raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 7,315,275€, prej tyre ishin shpenzuar 6,258,627€, apo 86%. Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e rrugëve lokale, ujësjellësve, kanalizimeve, parqeve nacionale, rregullimin e lumenjve etj.

#### Çështja A3 - Keq klasifikim i shpenzimeve

**Gjetja** Rregulla financiare nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike”, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Nga auditimi i pagesave, si dhe shpalosjet në raportin vjetor financiar, si rezultat i vendimeve përmbarimore/ gjyqësore, nga Thesari janë realizuar pagesa në vlerë 168,368€.

- Nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar 88,443€ për shpenzimet që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve/shujtave;
- Nga kategoria mallrave dhe shërbimeve janë paguar 46,225€ për shpenzimet që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve/shujtave.
- Nga kategoria e paga dhe medijt janë paguar 21,461€ për shpenzimet përmbarimore të cilat i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve; dhe
- Nga kategoria mallra dhe shërbime janë paguar 12,240€ takojnë kategorisë së investimeve kapitale.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet dhe si regjistrimit të shpenzimeve jo sipas kategorive ekonomike përkatëse.

**Ndikimi** Keq klasifikimi i shpenzimeve rezulton me pasqyrimin jo të plotë dhe jo të saktë të shpenzimeve në PVF, rrjedhimisht mund të shpie në keqkuptim të pozitës financiare të komunës me mbivlerësim/ nënvlerësim të kategorive ekonomike.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Të arkëtueshmet

Komuna në PVF e vitit 2023 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 7,657,555€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 3,740,343€, qiratë e dyqaneve 394,262€, qiratë e tokave 275,746€, qiratë e tregjeve 10€, tatimi në tokë (paluajtshmeri) 998,439€, si dhe taksa në firmë 2,228,764€.

### Çështja B5 - Mbivlerësimi i Llogarive të arkëtueshme

#### Gjetja

Ligji nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 10.1.1, përcakton se, tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Nga testimet e tatimit në pronën e paluajtshme, në një rast kemi vërejtur se komuna kishte ngarkuar me këtë taksë pronën/parcelën e cila ishte pronë komunale. Vlera e ngarkesës për vitin 2023 ishte 20,562€, dhe rrjedhimisht llogaritë e arkëtueshme të raportuara në PVF ishin mbivlerësuar për këtë shumë.

Mungesa e një rishikimi adekuat nga ana e komunës për aplikimin e ngarkesës komunale për tatimin mbi pronën e paluajtshme ka bërë që llogaritë e arkëtueshme të jenë të mbivlerësuar.

#### Ndikimi

Aplikimi i ngarkesës për pronën e paluajtshme e cila është pronë e komunës ka ndikuar direkt në rritjen e llogarive të arkëtueshme.

#### Rekomandimi B5

Kryetari duhet të siguroj forcimin e kontroleve të brendshme gjatë faturimit të tatimit në pronë dhe në rastet kur tatimi në pronë i ngarkohet pronave të cilat janë të liruara me ligj të bëjë shlyerjen e obligimeve të tyre.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>19,807,625</b>	<b>22,677,570</b>	<b>21,129,662</b>	<b>18,020,858</b>	<b>16,922,197</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	17,613,956	19,178,886	18,726,949	15,517,044	14,568,168
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	107,682	93,813
Të bartura nga viti i kaluar	0	917,179	631,930	494,061	623,022
Të hyrat vetanake	2,193,669	2,193,669	1,386,174	1,750,633	1,418,764
Donacionet vendore	0	1,656	0	4,540	2,143
Donacionet e jashtme	0	386,180	384,609	146,898	216,286

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 2,869,946€. Kjo rritje është rezultat i pranimit të buxhetit nga të hyrave të bartura nga viti paraprak, nga ndarjet e nivelit qendror, si dhe nga donacionet. Në vitin 2023 komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final, me një nivel më të ulët prej 3% në krahasim me vitin 2022. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>19,807,625</b>	<b>22,677,570</b>	<b>21,129,662</b>	<b>18,020,858</b>	<b>16,922,197</b>
Pagat dhe mëditjet	9,098,162	10,663,092	10,612,785	9,303,713	8,868,913
Mallrat dhe shërbimet	3,184,213	3,201,410	3,019,067	2,470,247	2,160,895
Komunalitë	551,919	566,623	339,610	382,760	331,882
Subvencionet dhe transferet	930,000	931,171	899,574	676,958	608,298
Investimet Kapitale	6,043,331	7,315,275	6,258,627	5,187,180	4,952,209

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar në total ishte rritur për shumën 1,564,930€. Kjo rritje ishte sipas rishikimit të buxhetit për shumën 1,514,930€, si dhe pjesa tjetër ishte ndikuar nga të hyrat e bartura nga viti paraprak prej 50,000€,
- Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë ishte rritur për shumën 31,900€, kjo rritje ishte ndikuar nga të hyrat e vitit aktual dhe të bartura nga viti i kaluar për shumën 29,744€ dhe granteve të përcaktuara të donatoreve në shumën 2,156€.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,171€, si rezultat i të hyrave të vitit aktual dhe atyre të bartura nga viti i kaluar.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,271,944€, ndryshimi në rritje ishte ndikuar nga të hyrat e vitit aktual si dhe ato të bartura në shumë prej 886,264€ dhe granteve të përcaktuara të donatorëve për 385,680€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2023 ishin në vlerë 2,397,442€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, participimet etj. Si dhe të hyrat nga donatorët në shumën prej 207,431€.


**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>2,193,669</b>	<b>2,193,669</b>	<b>2,397,438</b>	<b>1,834,297</b>	<b>1,863,618</b>
Të hyrat tatimore	1,285,452	1,285,452	1,023,369	884,224	968,556
Të hyrat jo tatimore	908,217	908,217	1,374,069	950,073	895,063

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 ka rezultuar me 17 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, nëntë(9) rekomandime janë zbatuar dhe tetë (8) rekomandime nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr.4.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.	Nuk janë marrë masat e nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave publike kornizë me çmim për njësi në mënyrë që të mos bëhet tejkalimi i tyre.	Janë marrë veprimet e nevojshme	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që projektet të mos iniciohen pa projekt konkret dhe pa buxhet dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që ato të përfundojnë me kohë sipas planit dinamik.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin

4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se punët shtesë realizohen vetëm nëse paraprakisht janë arsyetuar orët e punëve shtesë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, dhe se mbahet evidencë për orët dhe ditët e angazhimeve në punët shtesë.	Janë marrë veprimet e nevojshme	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet që kanë rezultuar me mos pagesë me kohë të obligimeve të cilat kanë rezultuar me ngritjen e padive dhe procedura gjyqësore/përmbartimore ndaj komunës. Para hyrjes në obligime të sigurohen fondet e nevojshme, si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve dhe në pagesën me kohë të obligimeve.	Janë marrë veprimet e nevojshme	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët projekteve të kontribuojnë që plani i menaxhimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga palët kontraktuese me qëllim të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale.	Janë marrë veprimet e nevojshme	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestitim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuara me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.	Janë marrë veprimet e nevojshme	I zbatuar
8.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë që raportet rregullta gjatë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme. Po ashtu, të sigurojë që të bëhet ripërtëritja e kontratave të parapara në marrëveshjet për qiradhënie.	Rekomandimi është zbatuar pjesërisht	Pjesërisht i zbatuar
10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP sipas kërkesave ligjore.	Janë marrë veprimet e nevojshme	I zbatuar

11.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit, në mënyrë që komisionet e vlerësimit të tenderëve bëjnë vlerësim dhe krahasim të drejt të ofertave. Po ashtu, të rishikoj procesin dhe të siguroj se janë përzgjedhur fituesit e përgjegjshëm duke pasur parasysh të gjitha kërkesat ligjore.	Janë marrë veprimet e nevojshme	I zbatuar
12.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj se të gjithë përfituesit raportojnë në mënyrë të rregullt lidhur me implementimin/realizimin e projekteve, dhe për të gjithë ata që nuk raportojnë me kohë të marrë vendim që mos të jenë përfitues të subvencioneve në thirrjet publike të viteve pasuese.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	I zbatuar
13.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se anëtarët që janë pjesë e komisioneve të vlerësimit, të respektojnë të gjitha kriteret e përcaktuara me Rregullore përkatëse. Po ashtu të sigurojë se shpallja publike bëhet komfor me rregullat ligjore me qëllim të dhënies së mundësisë për të gjithë OJQ-të, duke siguruar barazi në aplikim dhe vlerësim të drejtë dhe transparencë për fondet publike.	Janë marrë veprimet e nevojshme	I zbatuar
14.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që, hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore, gjegjësisht hartimin e tyre para inicimit të procedurave të prokurimit.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin
15.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj që përmes sistemit e-pasuria evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€. Po ashtu, duhet të siguroj se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe ti paraprijnë përgatitjes së PFV, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë.	Janë marrë veprimet e nevojshme	I zbatuar
16.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme gjatë faturimit të tatimit në pronë dhe në rastet kur tatimi në pronë i ngarkohet pronave të cilat janë të liruara me ligj të bëjë shlyerjen e obligimeve të tyre.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin
17.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që, obligimet të planifikohen/ buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë.	Rekomandimi është zbatuar pjesërisht	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Fejzullah Fejza, Udhëheqës i ekipit



Astrit Bllaca, Anëtar i ekipit



Arbresha Breznica Rama, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër confirmimi

			
Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosovo	Zyra Kombëtare e Auditimit Nacionalna Kancelarija Revizije National Audit Office		

**LETËR E KONFIRMIMIT**

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **KK-Suharekë** për vitin 2023 ;
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunitetit të Suharekës

Datë ; 26/06/2024




## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.